

KESH SH.A.
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik "AlbStar" shpk, NIPT J62903512W dhe adresë: Bul.Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Godina nr.2, Kati 5/1, Tiranë.

Procedura e Prokurimit: Procedurë e Hapur, me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF - 79089-07.12.2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "PUNIME MBROJTËSE TEK KRAHU I MAJTË I KANALIT TË DALJES NGA NDËRTESA E CENTRALIT DERI TEK URA SI DHE VESHJA ME BETON E FAQEVE ANËSORE TË KANALIT NË HEC KOMAN".

Fondi limit: 250,998,149 (Dyqind e pesëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë) Lek pa TVSH.

Burimi i financimit: Me të ardhurat e vetë KESH sh.a.

Kontrata do të realizohet në një afat: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 28, datë 16.07.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës 7 (shtatë) Operatorë Ekonomik me vlera të ofertave respektivisht:

- 1) OE "4 A-M" sh.p.k, NIPT K92005016L- 210,670,960.5 Lek pa TVSH;
- 2) BOE "GJOKA KONSTRUKSION" sh.a, NIPT J91815014U & "SELAMI" sh.p.k, NIPT J77304706L- 212,013,144 Lek pa TVSH;
- 3) BOE "SHANSI INVEST" sh.p.k, NIPT J61924002T & "BIBA- X" sh.p.k, NIPT K32618815N- 225,076,436 Lek pa TVSH;
- 4) OE "G.P.G COMPANY" sh.p.k, NIPT J64324443V- 227,782,800 Lek pa TVSH;
- 5) OE "ALBSTAR" sh.p.k, NIPT J62903512W- 229,931,626 Lek pa TVSH;
- 6) "CURRI" sh.p.k, NIPT J67902718S- 238,731,665 Lek pa TVSH;
- 7) BOE "GJIKURIA" sh.p.k, NIPT J62903456H & "ANTE- GROUP" sh.p.k, NIPT J62904100D- 243,459,647 Lek pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomik :

1. **"4 A-M " shpk me vlerë të ofertës 210,670,960.5 Lek pa TVSH, pasi :**

- 1) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin e kërkuar për punë të ngjashme (DTS, Kap 2.3 - Kapacitetin teknik, pika 1). OE ka paraqitur dokumentacion (kopje kontrata dhe vërtetim realizimi punimesh) për pesë kontrata të ngjashme nga ku rezulton se për katër nga kontratat e paraqitura OE nuk ka realizuar asnjë volum punimesh të ngjashëm me zërin "Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 1.0 m³, në kanale gjërësi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shkarkim në mjet" apo me zërin "Blloqe Betoni monolit" apo me zërin "Gabiona me rrjetë teli të zing, gure kave". Në kontratën e pestë "Mbrojtja e tubacioneve DN 650, DN 600, DN 350 në sektorin 5, në shtratin e Perroit të Selitës dhe në Gurore" me vlerë 17,709,875.40 Lekë (pa T.V.SH), OE rezulton se plotëson me punime të ngjashme vetëm afërsisht 0.4% të volumit të kërkuar në DST për keto tre zëra.
- 2) Kontrata e qirasë me Nr. 5326 Rep, dhe Nr.1023 Kol., datë 17/08/2018, lidhur nga Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk me Operatorin Ekonomik "BIBA X" shpk, për makineritë "Impjant për prodhimin e betonit" është e parregullt, pasi kjo makineri është e deklaruar në ofertë nga vetë qiradhënësi se do ta përdorë nga ai për këtë tender (makineria është referuar edhe në ofertën e "Shansi Invest" shpk në JV me "BIBA X" shpk).
- 3) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11). Kontrata e qirasë Nr. 5328 Rep, dhe Nr.1025 Kol., datë 17/08/2018, lidhur me Operatorin Ekonomik "SOND Emigranti" shpk, për makinerinë "ekskavator me krahë të gjatë mbi 20m, dhe peshë 25T, të pajisur me kovë dhe grejfer 1 m³" është e pavlefshme pasi deklarata e çdoganimit specifikon se mjeti është me peshë 23 Ton, jashtë përdorimit dhe i cmontuar, në kundërshtim me sa kërkohet në kriteret për kualifikim.
- 4) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11). Kontrata e qirasë Nr. 5329 Rep, dhe Nr.1026 Kol., datë 17/08/2018, lidhur me Operatorin Ekonomik "REDI" shpk, për makinerinë "ekskavator me krahë të gjatë mbi 18 m", është e parregullt pasi nuk ka asnjë dokumentacion që të vërtetojë se mjeti objekt qiraje është në pronësi të "REDI" shpk dhe periudha e qirase nuk mbulon të gjithë periudhën e zbatimit të punimeve pasi kjo kontratë është lidhur për 10 muaj dhe jo 12 muaj që kërkohet në dokumentat e tenderit.
- 5) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11). Kontrata e qirasë Nr. 5330 Rep, dhe Nr.1027 Kol., datë 17/08/2018, lidhur me Operatorin Ekonomik "DIBRANI" shpk, për makinerinë "ekskavator me krahë të gjatë mbi 18m", nuk është me objekt tenderi, kërkesë e kriterëve për kualifikim.

2. BOE "GJOKA KONSTRUKSION" sh.a, & "SELAMI" sh.p.k, me vlerë të ofertës 212,013,144 Lek pa TVSH, pasi :

- 1) Drejtuesi Teknik Ing. Haziz Arifaj, nuk rezulton të jetë pasqyruar në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar - Qershor 2018, kërkesë e VKM Nr.42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar dhe kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit.
- 2) Çertifikata ISO 50001-2011 e Operatorit Ekonomik "GJOKA Konstruktion" sh.a., nuk është e akredituar nga DPA, kriter për kualifikim siç përcaktohet në DT (bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.3330, date 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.145, datë 16.03.2018).

- 3) Çertifikata ISO 50001-2011, e Operatorit Ekonomik "Selami" sh.p.k., nuk është e akredituar nga DPA, kriter për kualifikim siç përcaktohet në DT (bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.3330, datë 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.145, datë 16.03.2018).
- 4) Vërtetimi i lëshuar nga OSHEE, me Nr.305 Prot., datë 17.08.2018 për kontratën me Nr. BU0C130065044739 konfirmon se "Selami" shpk është debitor në vlerën 123,512.80 lekë, në kundërshtim me VKM 914/2014, neni 26/7-c.
- 5) Operatorit Ekonomik "Selami" sh.p.k., në liçensën e zbatimit të punimeve i mungon kategoria NP-9A e domosdoshme për punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Sipas kontratës së bashkëpunimit do të kryejë punime lumore, në shtratin e lumit, pra OE nuk është i liçensuar për kryerjen e këtyre punimeve.
- 6) Dokumentacioni i paraqitur nga OE "Selami" shpk për Erlin Koçia si Inxhinieri Hidroteknik verteton se inxhinieri hidroteknik Erlin Koçia nuk plotëson kushtin e 5 viteve eksperience pune, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- 7) Operatorit Ekonomik "Selami" sh.p.k., tek deklarata mbi drejtuesin teknik, ka deklaruar Ing. Erlin Koçia, ky inxhinier nuk rezulton si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik për punimet e zbatimit, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- 8) Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "Gjoka Konstruksion" sha dhe "Selami" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11/7). BOE "Gjoka Konstruksion" sha & "Selami" shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për mjetin e kërkuar "Autovinc me Kapacitet mbi 10 Ton", kërkesë e kriterëve të DT për kualifikim.

3. BOE "SHANSI INVEST" sh.p.k. & "BIBA- X" sh.p.k, me vlerë të ofertës 225,076,436 Lek pa TVSH, pasi;

- 1) Operatori Ekonomik "Biba X" shpk, në liçensën e zbatimit të punimeve i mungon kategoria NP-9-A, punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Sipas kontratës së bashkëpunimit do të kryej punime lumore, në shtratin e lumit. pra Operatori Ekonomik Biba X" shpk, nuk është i liçensuar për kryerjen e këtyre punimeve, kërkesë e VKM 914/2014 Neni 74/3.
- 2) Operatori Ekonomik "Biba X" shpk, nuk plotëson kriterin e kërkuar për punë të ngjashme (DTS, Kap 2.3-kapacitetin teknik, pika 1). Nga analizimi i zërave të kontratës së paraqitur nga Biba X sh.p.k për punime të ngjashme dhe situacionit përfundimtar të punimeve të kësaj kontrate, nuk konstatohet se OE të ketë kryer asnjë prej zërave kryesor të objektit që tenderohet (gërmim në prezence uji apo i ngjashëm dhe mur gabion apo i ngjashëm).
- 3) Për Muajin Prill 2018 Listepagesa e Operatori Ekonomik "Biba X" shpk, është e palexueshme dhe nuk vërtetohen a janë apo jo në listëpagesa inxhinieret Gjeodet Bajram Muji dhe Inxhinieri i Mjedisit Fatjona Levani.
- 4) Bashkimi i Operatoreve Ekonomik "SHANSI INVEST" shpk dhe "Biba X" shpk, nuk plotëson kriterin për një Ing. Gjeolog me eksperience 10 vite punë (DST, Kap. 2.3, pika 5). Operatori Ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion për inxhinier gjeolog me eksperience 10 vjet (Festim Burza është diplomuar me 27.10.2010 ne Master Shkencor "Inxhinieri Ndertimi profil Gjeoteknike" dhe diploma e nivelit te pare (bachelor ne Inxhinieri Ndertimi dt. 16.10.2008) sic kërkohet në dokumentet e tenderit. Edhe Operatori Ekonomik "Biba -X" shpk, për inxhinierin Gjeolog Agim Hasalamaj nuk

vërteton eksperiencën 10 vjeçare, as në CV dhe as në librezën e punës paraqitur në këtë ofertë.

- 5) Për inxhinierin gjeodet të Operatori Ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k rezulton se kontrata dhe CV dhe diplomë janë në emer Kajtaz Rataj, i cili është diplomuar në vitin 1976, ndërsa në liçensë është me emrin Kajtaz Alikaj, dhe në të deklarohet se diplomë është bërë në vitin 1977. As vertetimi nuk vërteton se është i njëti person.
- 6) Operatori Ekonomik "Biba X" shpk., sipas kontratës së bashkëpunimit dhe zërave të punimeve që do të kryej secili anëtar i këtij JV, rezulton se do të kryej 20% të punimeve për çdo zë të preventivit, si e tillë ky OE duhet të plotësojë 20% të kapacitetit ekonomik dhe teknik për kryerjen e këtyre punëve. VKM 914/2014 Nenini 74-3. Nga verifikimi i dokumentacionit për makineri dhe paisje nuk plotësohet ky kriter dhe konkretisht:
 - a. Nuk plotëson kushtin për të paktën një kaminon me peshë mbajtëse 10-20 Ton, pasi nuk ka asnjë të tillë.
 - b. Nuk plotëson kushtin për të paktën një eskavator me krah jo më pak se 18m pasi nuk ka asnjë të tillë.
- 7) Operatori Ekonomik "Shansi Invest" shpk, nuk plotëson kushtin për kamionët me peshë mbajtje 10-20 ton pasi për mjetet me tragë AA503PT, KO0119B, KO9407B, për të cilat është lidhur kontratë qiraje me Nr.1453 Rep., dhe Nr.727 Kol, datë 09.08.2015, me subjekti "MILENIUM" sh.p.k rezulton të jetë e pavlefshme pasi për këtë kamion subjekti qiradhënës "MILENIUM" sh.p.k ka lidhur kontratë qiraje me Operatorin Ekonomik "NIKA" sh.p.k.
- 8) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SHANSI INVEST" shpk & "Biba X" shpk, nuk plotëson kushtin për impjant të prodhimit të betonit, pasi këtë impjant që ka paraqitur në ofertë operatori ekonomik "BIBA X" sh.p.k, subjekti qiradhënës "BIBA X" sh.p.k e ka dhënë me qira Operatorit Ekonomik 4 A-M sh.p.k (ofertues në këtë garë).
- 9) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k & "Biba X" sh.p.k, nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11/3) për dy mjete "Eskavator me kavo me krah të gjatë minimumi 20 m, me peshë mbi 25 ton, të paisur me kovë dhe greifer me kapacitet minimumi 1 m³". Më konkretisht:
- 10) Për njërin mjet OE "Shansi Invest" sh.p.k ka lidhur kontratë qiraje me datë 09.08.2018 me "SINA 98" sh.p.k për mjetin "Tipi C400 KRC Marka TELAIO me nr. Shasie C400ZX0130". Sipas dokumentacionit të paraqitur për të dokumentuar të dhënat e këtij mjeti (deklaratës së zhdoganimit, urdhër clirimi, foto) vërehet se mjeti i paraqitur cilësohet shprehimisht si "Makineri vetlëvizëse shpuese, zhytëse për shpim toke, nxjerrje minerali o xeherori" SONDE "SHPUSE HIDRAULIKE ME ZINXHIRE" pra është sondë shpimi dhe jo eskavator me kavo sic kërkohet në DST për të përmbushur kriterin për kapacitetin teknik.

4. G.P.G COMPANY" sh.p.k, me vlerë të ofertës 227,782,800 Lek pa TVSH pasi;

- 1) Operatori Ekonomik "G.P.G Company" shpk nuk plotëson kriterin e kerkuar për punë të ngjashme (DTS, Kap 2.3-kapacitetin teknik, pika 1). OE ka paraqit dokumentacion (kontrata dhe vertetim realizimi punimesh) për dy kontrata të ngjashme nga ku rezulton se OE plotëson me punime të ngjashme vetëm afërsisht 1.33% të volumit të kerkuar në DST për zerin "Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m³, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~ 2m, kategoria IV, me shkarkim në mjet" dhe nuk ka të realizuar asnjë volum punimi për zerin "Blloqe Betoni monolit dhe zerin "Gabiona me rrjete teli të zing, gure kave".

- 2) Operatori Ekonomik "G.P.G Company" shpk nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11/10) për "Pompë Stacionere për hedhje betoni me peshe min 6Ton". Me konkretisht, OE ka paraqitur si "Pompë Stacionere" mjetin me targe LU7260B TIP FIAT por dokumentacioni për këtë mjet verteton se nuk është një pompe stacionere për hedhje betoni (sic kërkohej në DST), por një automjet për hedhje betoni (Autopompe) dhe si i tillë nuk plotësohet kriteri për pompë stacionere për hedhje betoni.
- 3) OE "G.P.G Company" shpk nuk ka deklaruar me korrektësi kontratat e lidhura dhe/ose në proces (Shtojcën 11). Nga Buletini Javor i APP rezulton se OE "G.P.G Company" me datë 09.07.2018 është shpallur fituese në procedurën e prokurimit publik me objekt : "Ndërtim ByPass Tepelene, Loti 1" me fond Limit 2,394,360,362,35 Lek Pa TVSH por ky objekt nuk është paraqitur në shtojcën 11 të plotësuar nga ofertuesi "G.P.G Company" sh.p.k. gjë që ben që shtojca 11 të konsiderohet e paplotësuar dhe përben një kriter skualifikues.

5. "CURRI" sh.p.k, me vlerë të ofertës 238,731,665 Lek pa TVSH pasi;

- 1) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) për "Pompë Stacionere për hedhje betoni me peshë min 6 Ton". OE ka paraqitur faturë tatimore ku nuk përcaktohet kapaciteti i kësaj pompe.
- 2) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11) pasi kontrata e lidhur me "SHPRESA AL", sh.p.k, Nr 2120 REP,NR660 KOL, për 10 mjete, nuk është me objekt tenderi, kërkesë e kriterëve për kualifikim të DT.
- 3) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) për për mjetin "Autovinç me kapacitet mbi 10 ton" pasi kontrata qerash e lidhur ndërmjet "Curri" sh.p.k dhe Mimoza Gjani nuk është me objekt tenderi, kërkesë e kriterëve për kualifikim të DT.
- 4) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) për për mjetin "Buldozer", pasi kontrata e qerasë e lidhur ndërmjet "Curri" sh.p.k dhe "Geci" sh.p.k Nr.414 Rep, Nr.78 Kol nuk është me objekt tenderi, kërkesë e kriterëve për kualifikim, si dhe në Aktin e Zhdoganimit të paraqitur për këtë mjet specifikohet "Traktor me zinxhir Katerpillar me peshë 8 Ton".
- 5) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) për disponimin e mjetit "Rul vibruar me peshë 18 Ton", pasi në dokumentat e paraqitura nuk vërtetohet kapaciteti prej 18 ton kërkuar në kriteret për kualifikim të DT.
- 6) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike pasi nuk disponon gjenerator me fuqi mbi 200 KVA, kërkuar në kriteret për kualifikim të DT.
- 7) Operatori Ekonomik "Curri" sh.p.k nuk plotëson kriterin e kërkuar për stafin teknik. Inxhinieri Gjeolog (Elsa Doda) e përfshirë në licensën e OE, rezulton të jetë njëkohësisht pjesë e stafit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) në kundërshtim me VKM Nr.42 datë 16/01/2008, Kreu IV, Pika 2 - "Papajtuësmerite me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit". Kjo inxhinieri nuk ndodhet në listëpagesat e shoqërisë për muajin shkurt dhe nuk vërteton eksperiencën e punës 10 vjetore si Inxhinieri Gjeologe.
- 8) Operatori Ekonomik "CURRI" sh.p.k, nuk ka deklaruar me korrektësi kontratat e lidhura dhe/ose në proces (Shtojcën 11). Nga Buletini Javor i APP rezulton se OE "CURRI" sh.p.k në bashkëpunim me "Inerte EXPRES" sh.p.k, me datë 07.07.2018 janë shpallur fitues në procedurën e prokurimit publik me objekt "Rikonstruksioni Kab.Mur, Fiderat ..." me vlerë të ofertës 299,151,858 Lek por ky objekt nuk është paraqitur në shtojcën 11 të plotësuar nga

ofertuesi CURRI” sh.p.k, gjë që bën që shtojca 11 të konsiderohet e paplotësuar dhe përbën një kriter skualifikues.

6. BOE “GJIKURIA” sh.p.k, & “ANTE- GROUP” sh.p.k, me vlerë të ofertës 243,459,647 Lek pa TVSH pasi;

- 1) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Gjiguria" shpk & "Ante Group" shpk, nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 9) për Licensat Profesionale të lëshuara nga MPPT/MTI (NP 1/B, NP 4/A, NP 8/A, NP 9/D, NP 12/C, NS 1/B, NS 9/C, NS 18/B). Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga ky BOE vërehet se OE "Gjiguria" shpk posedon vetëm piken NP 9/C ndërsa OE "Ante Group" sh.p.k posedon vetëm piken NP 9/A pra nuk kanë licencën e kërkuar profesionale NP 9/D gjë që përben kriter skualifikimi. Gjiguria ka NP12 B jo C.
- 2) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Gjiguria" shpk & "Ante Group" shpk nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) pasi për paisjen çekiç pneumatik për thyerje guresh dhe betoni është paraqitur çekiç i përdorur për eksavator.
- 3) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Gjiguria" shpk & "Ante Group" shpk nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) pasi ka paraqitur 2 betoniere nga 4 të kërkuara.
- 4) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Gjiguria" shpk & "Ante Group" shpk nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) për impiantin e prodhimit të betonit. Në aktin e zhdoganimit bëhet fjalë për pjesë të përdorura të impiantit të perpunimit të betonit dhe jo impiant sic kërkohet në DT.
- 5) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Gjiguria" shpk & "Ante Group" shpk nuk plotëson kërkesat për kapacitetet teknike (DST, kap. 2.3 pika 11) për dy eskavatorët me kavo me krahe të gjatë me peshë mbi 25 ton. Aktet e zhdoganimit bashkelidhur me kontratën e qerazë me "ARTI" shpk të paraqitura janë të pa lexueshme.
- 6) Operatori Ekonomik "Gjiguria" shpk nuk ka deklaruar me korrektësi kontratat e lidhura dhe/ose në proces (Shtojcën 11). Nga Buletini Javor i APP rezulton se OE ka lidhur kontratën me vlerë 25,550,233 Lek me TVSH me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, gjë që bën që shtojca 11 të konsiderohet e paplotësuar dhe përben një kriter skualifikues.

II-Është kualifikuar si e vlefshme, oferta e ofertuesit "ALBSTAR" sh.p.k pasi ka paraqitur ofertën konform kërkesave të Dokumentave të Tenderit.

* * *

Duke i'u referuar procedurës së lartpërmendur informojmë Operatorin Ekonomik "Albstar" sh.p.k, NIPT J62903512W dhe adresë: Bul. Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Godina nr.2, Kati 5/1, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **229,931,626** (Dyqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzetë e gjashtë) Lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a, Blloku "Vasil Shanto" sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 31/08/2018.

Ankesa: Jo

□